



PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKBËRJE

Përmbledhje e raporteve rreth pjesëmarrjes së grupeve
punuese të CiviKos në procesin e konsultimit publik me
Qeverinë e Kosovës 2017 - 2018

Publikoi: Platforma CiviKos

Prishtinë, Gusht 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë. Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi e CiviKos-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKBËRJE

Përmbledhje e raporteve rreth pjesëmarrjes së grupeve
punuese të CiviKos në procesin e konsultimit publik me
Qeverinë e Kosovës 2017 - 2018

Përmbajtja

- 5** **Hyrja**
- 7** **Raport i monitorimit të procesit të konsultimit publik për Projektligjet e Pakos për Reformë në Administratë Publike**
- 8** **Raport i Konsultimit Publik për Projektligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës**
- 11** **Raport i Konsultimit Publik për tri Udhëzimet Administrative**

Hyrje

Në kuadër të projektit të financuar nga MATRA, CiviKos në bashkëpunim me Qendrat Rajonale në Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj ka themeluar tri grupe punuese me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e Standardeve Minimale për Procesin e Konsultimit Publik sipas Rregullores (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Tre koordinatorë të grupeve punuese janë përzgjedhur, të cilët në koordinim me Civikos kanë përzgjedhur draft ligjet dhe udhëzimet administrative për monitorim.

Dokumentet Qeveritare që janë përzgjedhur për monitorim të procesit të konsultimit publik janë:

- **Projektligji** për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- **Projektligjet e Pakos për Reformë në Administratë Publike që përfshijnë :**
 - *Projektligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,*
 - *Projektligji për Funksionarët Publik dhe;*
 - *Projektligji për Pagat.*
- Draft Udhëzimi Administrativ për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrave të Tatimit në Pronë.
- Draft Udhëzimi Administrativ për Metodologjinë e Vlerësimit dhe,
- Draft Udhëzimi Administrativ për Procedurat Ankimore.

Ky raport përbëhet nga tri pjesë dhe përfshinë procesin e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e politik-bërjes për ligjet e lartpërmendura, sukseset, sfidat dhe punën e grupeve punuese në këtë proces.

Raporti është përgatitur nga CiviKos me kontribut të Albulena Nrecaj, Afërdita Sylja-Shehu dhe Rina Kika, koordinatorë të tri grupeve punuese.

I

**RAPORT I MONITORIMIT TË PROCESIT
TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR
PROJEKTLIGJET E PAKOS PËR
REFORMË NË ADMINISTRATË PUBLIKE**

Raport i monitorimit të procesit të konsultimit publik për Projektligjet e Pakos për Reformë në Administratë Publike

Përgatitur nga Albulena Nrecaj - Koordinatore e Grupit Punues

Hyrje

Aplikimi standardeve minimale për procesin e konsultimit publik nga ana e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe kontributi i organizatave të shoqërisë civile dhe publikut janë objekt i trajtimit të këtij raporti, respektivisht, procesi i konsultimit publike rreth pakos së projektligjeve për reformën në Administratën Publike të Republikës së Kosovës, e cila përbehet nga tri (3) ligje:

- Projektligji për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,
- Projektligji për Funksonarët Publik dhe;
- Projektligji për Pagat.

Raporti përfshinë konsultën publike të monitoruar përmes platformës së konsultimeve publike dhe aktivitetet e ndërmarra në kuadër të angazhimit për trajnimin dhe asistimin e përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare rreth procesit të konsultimit publik.

Zbatimi i rregullores për standardet minimale për procesin e konsultimit

Programi legjislativ për vitin 2018¹ i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kishte paraparë hartimin Projektligjit për Shërbyesit Civil dhe Projektligjin për Administratën Publike, emërtimi i së cilave më pas është ndryshuar nga grupi punues sipas kërkesave të Bashkimit Evropian në Projektligji për Zyrtarët Publik dhe Projektligji për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Vendimi për hartimin e Projektligjit për Paga ishte marrë në mbledhjen e 35-të të Qeverisë së Repub-

¹ Programi Legjislativ 2018, I qashëm në: <http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/07/PROGRAMI-LEG-JISLATIV-PER-VITIN-2018.pdf>

likës së Kosovës² dhe sipas Rregullores së Punës të Qeverisë, ky Projektligj me automatizëm është fuzionuar në Programin Legjislativ për vitin 2018. Afati për publikimin e draftit të projektligjeve sipas programit legjislativ ishte më 25 qershor 2018 nga ana e MAP-it. Megjithatë, nisma për hartimin e këtyre projekt ligjeve kishte filluar qysh në vitin 2017, dhe takimet e para të grupit punues gjatë vitit 2017 nuk janë objekt të këtij raporti.

Më 8 qershor 2018, MAP publikon në platformën e konsultimeve publike të tri (3) projektligjet si dhe dokumentet e konsultimit për projektligjet respektive, duke përfshirë informata për problemet kryesore që adresohen përmes projektligjeve, dokumentet zyrtare që autorizojnë përgatitjen e projektligjeve, objektivat që parashihen të arrihen me këtë projektligje, qëllimin e konsultimit, si dhe informata për mënyrat dhe afatin e dorëzimit të kontributeve nga ana e publikut. Vlen të theksohet se dokumentet me të gjitha këto informata janë publikuar në të gjitha gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

Konsulta ka qenë e hapur për njëzet (20) ditë kalendarike, nga data 8 qershor deri më 28 qershor 2018. Në platformë gjithashtu, ishte vënë në dispozicion emri, mbiemri dhe e-mail adresa e presonit përgjegjës.

Të dhënat në vazhdim paraqesin në mënyrë tabelare rezultatet e procesit të konsultimit publik në nivel qeveritar, sipas metodologjisë së zhvilluar nga Fondacioni për Shoqëri Civile (KCSF), për monitorimin e procesit të konsultimit publik.

Nën-Kategoritë	Përqindja e pikëve	Pikët totale
1 – Parakushtet për vendimmarrje gjithëpërfshirëse	88.24%	15 Pikë
2 – Zbatimi i konsultimit	66.66%	10
3 – Informatat kthyese	11.76%	2
Totali i Përgjithshëm	55.10%	27

Takimet publike para publikimit të draft projektligjeve në platformën e konsultimeve

Informatat në vazhdim paraqesin takimet publike të mbajtura vetëm gjatë vitit 2018. Ashtu si u tha më lartë, në këtë raport, nuk janë të trajtuara takimet e grupit punues me publikun, dhe OJQ-të, gjatë vitit 2017. Gjithashtu, vlen të theksohet se përbërja e grupit punues nuk ka reflektuar ndonjë anëtarë të shoqërisë civile gjatë draftimit të projektligjeve.

Në muajin Prill dhe Qershor, MAP, ka organizuar 2 takime (1 takim për muaj) takime publike me palë

2 Vendimi Nr.05/35 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i qasshëm në: http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/03/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_35_t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2018...pdf

të interesuara, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe organizatat e shoqërisë civile, si GAP, GLPS, për të diskutuar draftet e projektligjeve. Asnjë takim nuk është thirrur vetëm me OJQ.

Takimet e grupit punues (CIVIKOS)

Më 21 qershor 2018, është mbajtur takimi i grupit punues me shoqërinë civile, ku është prezantuar përmbajtja e projektligjeve, si dhe është diskutuar për hapat e më tutjeshëm. Gjithashtu, ky takim ka shërbyer edhe për trajnimin e OJQ-ve rreth mënyrës së si të regjistrohen dhe ta përdorin platformën e konsultimeve publike. Komentet kryesore të pjesëmarrësve rreth projektligjeve janë fokusuar në trajtimin e barabartë përmes këtyre ligjeve të zyrtarëve publik që shërbejnë në nivel lokal dhe të atyre në nivel qendror, pasi që deri më tani ka pasur diskrepancë të madhe sa i përket pozitave dhe pagave. Megjithatë, OJQ-të pjesëmarrëse nuk kanë shfaqur ndonjë interesim të madh për të avokuar për ndonjë pjesë që do të kishte nevojë të adresohet përmes ndryshimeve ligjore, apo plotësimit të projektligjeve.

Ecuria e konsultimit publik përmes platformës elektronike

Ministria e Administratës Publike , me 8 qershor 2018, ka publikuar pakon e projektligjeve për Reformë në Administratë Publike, respektivisht (i) Projektligjin për Zyrtarët Publik, (ii) Projektligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore, dhe Agjencioneve të Pavaruara dhe, (iii) Projektligjin për Paga. Konsulta me shkrim ka qenë e hapur për njëzet (20) ditë kalendarike apo pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, a deri më 28 qershor 2018. Së bashku me projektligjet, janë publikuar edhe dokumentet për konsultim për secilin projektligj, në të gjitha gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Dokumentet për konsultim kanë përfshirë përshkrimin e shkurtë të dokumentit, përshkrimin e problemit, qëllimin e konsultimit, çështjet kryesore që përmban dokumenti, mënyrën dhe afatin për dërgimin e komenteve, personin përgjegjës dhe e-mail adresën e tij.

- a) Për Projektligjin për Paga, gjatë periudhës së konsultimit janë dërguar gjithsej shtatë (7) kontribute/komente.
- b) Për Projektligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura janë dërguar gjithsej gjashtë (6) kontribute/komente
- c) Për Projektligjin për Zyrtarët Publik janë dërguar gjithsej pesë (5) kontribute/komente

Projektligjet	Datat/ Kohëzgjatja	Nr. i pjesëmarrësve/Kon- tribuesve	Qytetarë OJQ dhe Shoqëria Civile	Institucione publike
Projektligji për Zyr- tarët Publik	15 ditë pune	5 kontribues	1 qytetarë	4
Projektligji për Or- ganizmin dhe Funk- sionimin e Admin- istratës Shtetërore dhe Agjencioneve të Pavarura	15 ditë pune	6 kontribues	2 qytetarë	4
Projektligji për Paga	15 ditë pune	7 kontribues	1 qytetarë	6

*Gjatë procesit të konsultimit përmes platformës asnjë OJQ, nuk ka dhënë ndonjë kontribut.

Takimet Publike pas publikimit të draft projektligjeve në platformën e konsultimeve

Më 13 qershor 2018, në bashkëpunim me MAP kemi organizuar takimin publik me qytetarë dhe OJQ-të për të diskutuar draftet e projektligjeve, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe zyrtarë publik nga komunat e rajonit të Ferizajt. Pjesëmarrësve iu është ofruar materiali i përmbajtjes së projektligjeve në verizionin e shkurtuar, i cili ka përfshirë qëllimin dhe problemet të cilat pretendohet të adresohen përmes këtyre ligjeve. Mirëpo, pas takimit publik, nuk ka pasur ndonjë *feedback* nga MAP, për të njoftuar pjesëmarrësit përmes e-mailit rreth statusit të komenteve apo kontributeve të tyre, si dhe përmbledhja e takimit në përgjithësi.

Takime të njëjta janë zhvilluar edhe në Pejë, Gjilan dhe Prishtinë, ku organizimi i takimeve publike është bërë në bashkëpunim me OJQ-të (Syri i Vizionit, INPO, PIPS).

Raporti final i konsultimit përmes platformës së konsultimeve

Kanë kaluar më shumë se një (1) muaj e gjysmë prej mbylljes së afatit për dhënien e kontributeve, dhe MAP, respektivisht, personi përgjegjës, nuk ka publikuar akoma raportin nga procesi i konsultimit publik, si dhe projektligjet në formën finale. Sipas, personit përgjegjës, raporti final do të publikohet pasi që projektligjet të dorëzohen në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës.³ Rrjedhimisht, komentet dhe kontributet e dhëna gjatë takimeve publike të organizuara nga MAP-i, si dhe kontributet përmes platformës nuk dihet nëse janë pranuar apo refuzuar, respektivisht, nuk dihet përmbajtja

³ Intervistë përmes telefonit, me [z.Naser](#) Shamolli, përgjegjës për konsultën publike, MAP

finale e projektligjeve të cilat pritet t'i dorëzohen Zyrës së Kryeministrit.

Gjetje nga monitorimi

Procesi i monitorimit të konsultimit publik ka nxjerrur në pah disa aspekte të cilat duhet të adresohen sa i përket arritjes së efektit dhe zbatimit përmbajtjesor të rregullores për konsultim publik. Vlerësoj se zbatimi i rregullores për standardet minimale për procesin e konsultimit publik nga MAP është bërë vetëm në aspektin „teknik“ duke zbatuar mekanikisht obligimet që dalin nga rregullorja. Këtë pohim e bazoj në argumentet si më poshtë:

1. Konsulta Publike përmes Platformës për tri (3) projektligje në të njëjtën kohë, nga i njëjti institucion, duke mos e zgatur afatin për dhënien e kontributit, minimizon mundësitë për të pasur një konsultë përmbajtjesore dhe efektive.
2. Një person nuk mund të jetë përgjegjës për tri (3) konsulta publike, respektivisht, (tri) projektligje, pasi është pothuajse pamundur për nga aspekti kohor dhe kualitativ të angazhohet në komunikimin me publikun dhe zbatimin e obligimeve që dalin nga rregullorja.
3. MAP, nuk ka organizuar takime të veçanta me OJQ-të për të diskutuar përmbajtjen e projektligjeve. Takimet e mbajtura kanë qenë gjithëpërfshirëse, ku kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të nivelit qendror e lokal dhe përfaqësues të ndryshëm nga institucione e organizata ndërkombëtare.
4. Edhe nga shoqëria civile ka qenë një numër i vogël i pjesëmarrësve pasi nuk ka shumë organizata që kanë ekspertizë në fushën e caktuar

Hapat e ardhshëm dhe rekomandime për procesin e konsultimit publik

Me qëllim të adresimit të problemeve dhe pengesave të listuara më lartë, rekomandoj që:

1. Në rastet kur kemi PAKO të Projektligjeve, që së bashku rregullojnë një fushë të caktuar, të zgjatet afati i konsultimeve publike.
2. Një zyrtarë të jetë përgjegjës vetëm për konsultën e vetëm të një projektligji, në mënyrë që të ketë hapësirën dhe komoditetin e duhur për komunikimin me publikun dhe gjithashtu zbatimin efikas të obligimeve që burojnë nga rregullorja
3. Të organizohen takime publike me OJQ që nga faza e hershme e hartimit të projektligjeve. Të mbahen të informuar rreth „përditësimit“ të projektligjeve si rezultat i kontributit të tyre.
4. OJQ-të të jenë më proaktive në procesin e vendimmarrjes në politika publike.
5. Të organizohen më shumë trajnime për përfaqësues të shoqërisë civile sa i përket pjesëmarrjes në politik-bërje.

I

I

**RAPORT I KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTLIGJIN PËR DHËNIEN
NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIM TË PRONËS
SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS.**

Raport i Konsultimit Publik për Projektligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Përgatitur nga Rina Kika - Koordinatorë e grupit punues

Hyrje

Ky raport paraqet zhvillimin e procesit të konsultimit publik në nivel qeveritar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për Projektligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Më poshtë janë të listuara rezultatet sipas metodologjisë së monitorimit të proceseve individuale të konsultimeve të zhvilluar nga KCSF, si dhe raporti narrativ i rrjedhës kronologjike të zhvillimeve të procesit të konsultimit publik. Vlen të përmendet se vlerësimi i procesit të konsultimit publik i paraqitur në formën tabelare i referohet vetëm procesit të konsultimit publik të mbajtur për të dytën herë, dhe jo procesit të konsultimit publik të mbajtur në nëntor 2017. Ndërsa raporti narrativ i përfshinë të dy proceset e konsultimit publik të cilat janë zhvilluar nga MAPL për të njëjtin projektligj.

MONITORIMI I PROCESVEVE INDIVIDUALE TË KONSULTIMEVE

Tabela në vazhdim paraqet pasqyrimin e rezultateve të procesit të konsultimit publik në nivel qeveritar, sipas metodologjisë së monitorimit të procesit të konsultimit publik të zhvilluar nga KCSF. Për më shumë informata, shihni raportin sipas Metodologjisë.

Nën-Kategoritë	Përqindja e pikëve	Pikët totale
1 – Parakushtet për vendimmarrje gjithëpërfshirëse	71%	12 Pikë
2 – Zbatimi i konsultimit	80%	12
3 – Informatat kthyesë	12%	2
Totali i Përgjithshëm	53%	26

KONSULTIMI I PARË PUBLIK

Takimet e Grupit Punues të MAPL

Me 12 dhe 13 tetor 2017, MAPL mbajti punëtorinë në Hotel Sharr në Prevallë për finalizimin e Projektligjit. Në këtë punëtori, u paraqit për herë të parë propozimi për përfshirjen e një procesi të posaçëm të dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës për qëllime jofitimprurëse nga Komuniteti Termokiss (OJQ Rritu) dhe Fondacioni Lumbardhi.

Anëtarët e grupit punues nga MAPL kërkuan që propozimi të jepet me shkrim dhe t'i dërgohet grupit punues përmes postës elektronike, andaj më datë 2 nëntor 2018 këto dy organizata e dërguan një dokument prej 15 faqesh i cili e shtjellon problematikën e qasjes në prona të komunës nga shoqëria civile, dhe propozon rekomandime për ndryshimin e projektligjit duke marrë si shembull shtete si Sllovenia, Austria, Holanda, Gjermania, Spanja e Britania e Madhe. Ndër të tjera u dha propozimi që 20% të pronave të secilës komunë të destinohen për shfrytëzim jo-fitimprurës. Një tjetër propozim ishte edhe kundërshtimi i ndryshimit të ligjit që parashihte që procesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së komunës për periudhën 0 deri në 1 vit të rregullohet me procedurë të njëjtë me dhënien në shfrytëzim të pronës për periudhën kohore prej 1 deri në 15 vite. Ligji aktual e lë në diskrecionin e komunave dhënien në shfrytëzim të pronës komunale deri në 1 vit pa procedurat burokratike të kalimit përmes Asamblesë Komunale. Ndërsa në draftin e Projektligjit që u dërgua për takimin e parë të grupit punues, procesi i dhënies në shfrytëzim deri në 1 vit, ishte përfshirë në procesin e njëjtë si marrja në shfrytëzim deri në 15 vite. Gjatë takimeve me grupin punues është diskutuar shumë çështja e rregullimit të procesit të dhënies në shfrytëzim deri në 1 vit.

Konsultimi i Parë Publik

Projektligji është publikuar për konsultim publik në web faqen konsultimet.rks-gov.net më datë 3 nëntor 2017 dhe vazhdoi të jetë i hapur deri më 23 nëntor 2017. Në këtë proces të konsultimit, u dha vetëm një koment nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët e cila kishte të bënte me përkthimin e saktë të versioneve të gjuhëve të ligjit.

Më 24 nëntor 2017 u mbajt një takim tjetër i grupit punues të MAPL ku u ftuan edhe pjesëtarë të shoqërisë civile. Në këtë takim u konfirmua se rekomandimet janë pranuar dhe se për to do të vendoset nga grupi punues.

Më 27 nëntor 2017, kryetari i grupit punues, Z. Fatos Qerimi u intervistua nga revista Kosovo 2.0 në lidhje me rekomandimet për ndryshimin e ligjit duke theksuar se kjo çështje do të mund rregullohet në dy mënyra të ndryshme:

- (1) Përmes negociatave të subjektit jo-fitimprurës me kryetarin e komunës dhe;
- (2) Përmes kërkesës së subjektit jo-fitimprurës ndaj institucioneve të shtetit.¹

¹ Kosovo 2.0, *A janë pronat publike vetëm për biznes*, 27 nëntor 2017, <http://kosovotwopointzero.com/public-property-just-business/>.

Në mungesë të një përgjigje zyrtare në lidhje me rekomandimet për ndryshimin e ligjeve, me 12 dhjetor 2017, Komuniteti Termokis ia dërgoi edhe një dokument me rekomandime shtesë kryetarit të grupit punues të MAPL me të cilin paraqiti arsye se përse rregullimi i procesit në mënyrat e paraqitura nga kryetari i grupit punues nuk do ta adresonin problemin. U ripërsërit se mënyra më e mirë e rregullimit të këtij procesi është përcaktimi i një procesi të veçantë konkurrues në mes të subjekteve jo-fitimprurëse, pa e patur si kriter kryesor çmimin më të lartë.

Më 13 dhjetor 2017, në lidhje me rekomandimet e bëra, u publikua Deklarata e Përbashkët për një Ligj me #MundësiPërKrejt, e cila u nënshkrua nga 53 organizata.² Kjo deklaratë u dërgua dhe protokolua në MAPL dhe po ashtu është dërguar dhe protokoluuar në Zyrën e Kryeministrit bashkë me një letër shpjeguese të procesit të komunikimit me MAPL dhe zhvillimeve në lidhje me çështjen e propozimit të ndryshimit të ligjit. Po ashtu, në kuadër të kësaj kampanje Komuniteti Termokis lansoi një video e cila e shpjegon problemin e qasjes në pronat komunale nga shoqëria civile.³

Raporti Final i Konsultimit të Parë Publik

Më 22 dhjetor 2017 në platformën e konsultimeve publike online u publikua Raporti Final i konsultimit publik. Në faqe 13, pika 69 të Raportit Final specifikohet se propozimi për dhënien e pronës në shfrytëzim për qëllime jo-fitimprurëse pranohet pjesërisht dhe se kjo do të rregullohet nga Qeveria me akt nënligjor. Këtu vlen të përmendet se në Raportin Final të konsultimeve publike përmbajtja e propozimeve të dhëna nga Komuniteti Termokis dhe Fondacioni Lumbardhi është ndryshuar dhe përshtatur duke përfshirë pjesë tjera. Përveç ndryshimit sipërfaqësor të përmbajtjes së pikës së mësipërme, në faqe 10, pika 42 e Raportit Final MAPL thekson se pranohet rekomandimi si vijon:

“Të rregullohet mundësia për OJQ-të dhe **shoqatat e veteranëve**, që të marrin pronën e komunës në shfrytëzim për qëllime jo fitim prurës apo të rregullohet me akt nënligjor nga MAPL”

Mungesa e hapësirave për shoqatat e veteranëve asnjëherë nuk është trajtuar gjatë diskutimit publik dhe nuk ka asnjë informatë publike për ndonjë propozim të tillë të dhënë nga shoqëria civile.

Po ashtu, Komuniteti Termokis ka paraqitur propozim që 20% e pronave të komunës të destinohet për shfrytëzim jo-fitimprurës. Raporti në faqe 8, pika 27 përcakton se ky propozim nuk pranohet me arsyetimin se: «Nuk është paraparë në koncept dokument të miratuar nga Qeveria».

Ky arsyetim për refuzim është i mangët dhe jo-serioz. Po që se projektligjet do të duhej të parashohin vetëm çështjet e adresuara në koncept dokument, atëherë nuk do të kishte fare kuptim që të zhvillohej një proces i konsultimit publik. I njëjti arsyetim është dhënë në një numër të propozimeve të dhëna për ndryshim të ligjit.

² Termokis, *Deklaratë e Përbashkët për një Ligj me #MundësiPërKrejt*, <https://bit.ly/2E6Zlo3>.

³ Termokis, *Pronat publike, për publikun #MundësiPërKrejt*, (video) https://www.facebook.com/Termokis/videos/2054223591474529/?hc_ref=ARRCtsliPdAmg9dguUuBOxm9fAKjmfTC5IMh0xcb92iVVlJ3lgiEmlrJLloKP8onToo8o.

Sipas Planit Legjislativ të vitit 2017, Projektligji ka qenë dashur të dërgohet në Kuvendin e Kosovës më 31 dhjetor 2017. Mirëpo ky afat është shtyrë për muajin prill 2018, kryesisht për shkak se MAPL deshi t'i konsultonte kryetarët e ri të Komunave për Projektligjin të zgjedhur në zgjedhjet lokale në fund të vitit 2017.⁴

Propozimi që procesi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës deri në 1 vit të mos përfshihet në procedurën e njëjtë të dhënies në shfrytëzim si për kohëzgjatjen 2 deri në 15 vite u pranua nga MAPL. Në raport u përcaktua se dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për kohëzgjatje deri në 1 vit do të rregullohet me akt nënligjor, duke e diferencuar kështu nga procesi nëpër të cilin duhet të kalohet për marrjen në shfrytëzim të pronës së komunës deri në 15 vite.

KONSULTIMI I DYTË PUBLIK

Takimet e grupit punues të MAPL dhe grupit punues të Civikos

Më 5 mars 2018, u dërgua ftesa për takimin e grupit punues ndërmintor dhe bashkë me të u dërgua edhe drafti më i fundit i Projektligjit. Pavarësisht se në Raportin Final të konsultimeve publike të publikuar më datë 22 dhjetor 2017 u theksua se është pranuar propozimi për rregullimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për qëllime jo-fitimprurëse, drafti i dërguar i projektligjit nuk e përmbante këtë dispozitë.

Më datë 7 mars 2018, u mbajt takim me grupin punues ndërmintor në Qeveri i cili zgjati rreth një orë. Në këtë takim, sërish u përsërit kërkesa për përfshirjen e një procesi të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për qëllime jo-fitimprurëse dhe u zhvillua debat në lidhje me këtë temë me përfaqësuesin e Asociacionit të Komunave i cili e kundërshtoi fuqishëm këtë propozim me pretekstin se do t'i lejonte shoqërisë civile të keqpërdorte pronën komunale.

Më 14 mars 2018 dhe 27 mars 2018 u mbajtën takimet e grupit punues të Civikos ku u diskutuan çështje të ndryshme në lidhje me çështjet që mund të inkuadrohen në projektligj. Po ashtu, përfaqësuesit e organizatave u inkurajuan që të japin kontribute në platformën online të konsultimeve publike sapo të hapet projektligji për komente online.

Më 16 mars 2018 u mbajt takimi i grupit punues dhe të përfaqësuesve të komunave të Kosovës ku ndër të tjera përfaqësuesit nga Komuna e Prishtinës dhe Dragashit theksuan se e përkrahin propozimin e shoqërisë civile për ndryshimin e ligjit.

⁴ Informata nga takimi i datës 18 janar 2018, me Sekretaren e Përgjithshme të MAPL, Znj. Rozafa Ukimeraj.

Konsultimi Publik

Në konsultimin e dytë publik për këtë ligj nuk është thirrur takim zyrtar i hapur me shoqërinë civile. Më datë 19 prill 2018, u hap procesi i konsultimit në platformën e konsultimeve publike online ku u publikua drafti i Projektligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës i datës 19 mars 2018.⁵ Në këtë draft sërish nuk u përfshi asnjë dispozitë që e rregullon procesin e dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës për qëllime jo-fitimprurëse.

Konsultimi publik online qëndroi hapur deri më datë 6 prill 2018. Gjatë kësaj periudhe u dhanë gjithsej **61 kontribute**, nga to, ishin **43 qytetarë** nga shoqëria civile dhe **18 organizata** të shoqërisë civile.⁶ Shumica dërmuese e kontributeve adresuan çështjen e rregullimit të një procesi të veçantë që i referohet vetëm dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për qëllime jo-fitimprurëse.⁷

Kontributet e shumta nga shoqëria civile erdhën si rezultat i kampanjës vetëdijësuese të realizuar nga Komuniteti Termokiss si dhe thirrjes së publikuar përmes rrjetit social Facebook për tu regjistruar në platformën e konsultimeve publike online dhe për të përkrahur propozimin #MundësiPërKrejt.⁸ Si rezultat i kësaj thirrje shumë individë dhe organizata u regjistruan për herë të parë në këtë platformë dhe e dhanë kontributin e tyre të parë në platformën e konsultimeve publike online.

Më 27 prill 2018, MAPL ia dërgoi grupit punues ndërministror versionin e Projektligjit pas përfundimit të konsultimeve publike ku në nenin 7, paragrafi 3 dhe 4 parashihet si vijon:

- Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronat e paluajtshme të komunës në periudhën organizatave të shoqërisë civile me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm.
- Me akt nënligjor rregullohen dhe përcaktohen procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për subjektet përfituese.”

5 Konsultimi Publik, Republika e Kosovës, Qeveria – Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, *Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës*, <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40328>.

6 Ibid.

7 Ibid.

8 Termokiss, *Pronat publike, për publikun #MundësiPërKrejt*, (video & shpjegim si të komentohet në platformën e konsultimeve online) https://www.facebook.com/Termokiss/videos/2054223591474529/?hc_ref=ARRCtsliPdAmg9dgUuBOxm9fAKjmfTC5IMh0xcb92iVVLj3lgiEmlrJLoKP8onToo8o.

SHËNIME SHITESË

Duhet përmendur se gjatë të dy konsultimeve publike Sekretarja e Përgjithshme e MAPL, znj, Rozafa Ukimeraj gjithnjë ka qenë e qasshme përmes emailit dhe gjithmonë ka qenë e gatshme të takohet me ne si pjesëtarë të shoqërisë civile dhe të dëgjojë propozimet dhe rekomandimet e tona. Sekretarja e MAPL është shembulli më i mirë që e kemi hasur gjatë tërë procesit të konsultimit publik si zyrtare shtetërore e cila e kupton rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile por edhe rëndësinë dhe përgjegjësinë e saj si zyrtare e shtetit. Nga muaji dhjetor 2017 deri në prill 2018 janë zhvilluar rreth 4 takime me Sekretaren dhe në të gjithë këto takime ajo ka qenë mikpritëse, e hapur për të diskutuar dhe ka dhënë informacione konkrete për procesin.

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Në bazë të zhvillimeve të këtij procesi të konsultimit publik, konsideroj se është e rëndësishme që në të ardhmen të adresohen dhe përmirësohen këto çështje:

1. Ministritë të bëjnë më shumë përpjekje për thirrjen e shoqërisë civile në diskutime publike nga momenti i hartimit të koncept dokumentit e deri në përpilimin e draftit të fundit të Projektligjit.
2. Në Raportin e procesit të konsultimit të përfshihen propozimet e cituara nga shoqëria civile dhe të mos ndryshohet përmbajtja e tyre. Në rast se kanë komentuar një numër organizatash për çështjen e njëjtë, të përfshihen të gjithë emrat a tyre.
3. Në rast të refuzimit të propozimeve të për ndryshim të projektligjit të jepen arsyetime të thukta se përse propozimi refuzohet dhe zyrtarët e qeverisë të informohen se propozimet e shoqërisë civile kanë rëndësi qendrore për procesin e draftimit të projektligjeve edhe nëse propozimet që jepen nuk janë pjesë e koncept dokumentit fillestar të Projektligjit.

I

I

I

**RAPORT I KONSULTIMIT PUBLIK
PËR TRI UDHËZIMET ADMINISTRATIVE**

Raport i Konsultimit Publik për tri Udhëzimet Administrative

Përgatitur nga Aferdita Sylaj Shehu - Koordinatore e Grupit punues

Ky raport paraqet zhvillimin e procesit të konsultimit publik në nivel qeveritar nga Ministria e Financave për Udhëzimet Administrative:

- DRAFT UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRAVE TË TATIMIT NË PRONË
- DRAFT UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR METODOLOGJINË E VLERËSIMIT
- DRAFT UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR PROCEDURAT ANKIMORE

Me datë 16 Prill 2018 përfaqësues të Ministrisë së financave kërkuan nga Civikos caktimin e një përfaqësuesi të shoqërisë civile të jetë anëtar i grupit punues për Aktet nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Kjo si një hap të parë të cilin Shoqëria Civile e vlerëson dhe është i përfshirë si një nga kategoritë në metodologjinë e monitorimit të proceseve individuale të konsultimeve të zhvilluar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile , kategori e vetmja që është plotësuar nga ana e Ministrisë së Financave që nga fillimi i procesit të hartimit dhe amandamentimit të akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Tatimin në pronën e Paluajtshme e të cilat janë të parapara si në vijim:

- Projekt U.A për Procedurat Ankimore;
- Projekt U.A për Kategoritë e Vlerave, Metodadat dhe Modelet e Vlerësimit;
- Projekt U.A për Regjistrat e Tatimit në Pronë, Përgjegjësitë dhe Procedurat për Regjistrimin dhe Menaxhimin e Informacionit;
- Projekt Rregullore për Strukturën Organizative të Njësive për Administrimin e Tatimit në Pronë në Komuna dhe Parimet e Administrimit Tatimor;
- Projekt Rregullore për Përgjegjësitë, Procedurat e Funkcionimit dhe Mënyrën e Kompensimit të Kryetarit dhe Anëtarëve të KMLVFPP;
- Projekt U.A për Shtyrjen e Afatit për Pagesën e Detyrimeve:

- Projekt U.A për Shërbimet Komunale që Pezullohen për Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore të Papaguara;
- Projekt U.A për Procedurat e Komunikimit Ndërmjet Autoriteteve Publike, Personave juridik.

Që nga angazhimi në Prill të 2018 e deri në kohën e raportimit tri (3) takime të grupit punues ndërmërorë janë organizuar ku janë diskutuar tri (3) U.A të lartshënuara.

Paraprakisht me 02.05.2018 jemi njoftuar përmes emailit që do të diskutohen gjashtë (6) Udhëzime Administrative dhe dy (2) projekt-rregullore.

Me datë 17, dhe 21 Maj është dërguar konfirmimi nga Ministria e Financave për fillimin e procesit të konsultimit publik.

Me datë 22 Maj është dërguar njoftimi për është themelimin e grupit punues ndërmërorë me vendimin e datës 16.04.2018 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, ku përfaqësuesit e CiviKos janë ftuar për takimin e parë të grupit punues.

Takimi i parë - rreth Udhëzimit Administrativ për Procedurat Ankimore, për Funkcionimin e Zyrave për Tatimin në Pronë, si dhe ai për Metodologjinë e Vlerësimit

Takimi i grupit punues është mbajtur me datën 07 Qershor 2018 në zyrat e Ministrisë së Financave. Takimi ka qenë i karakterit informues rreth UA të cilat do të hartohen si dhe njoftimit me anëtarët e grupit dhe procedurat se si do të veprohet. Në takim ishin prezent Drejtori i Departamentit të Tatimit në Pronë, zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, Zyrtar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, zyrtarë nga Ministria e Financave si dhe këshilltari në Ministrinë e Financave për hartimin e këtyre Udhëzimeve Administrative.

Takimi i dytë - rreth UA për procedurat ankimore, për funksionimin e zyrave për tatimin në pronë si dhe ai për metodologjinë e vlerësimit - 31 korrik 2018, Prishtinë, Ministria e financave

Në takimin e dytë të radhë sa i përket tatimit në pronë të pranishëm në takim ishin tetë (8) pjesëmarrës Agron Thaqi – Udhëheqës i Divizionit të vlerësimit të pronave të paluajtshme, Lumnije Hetemi – Zyrtare Ligjore, Dashurije Kuqi – Inspektore e Tatimit në Pronë, Drini Çano - Projekti ProTax 2 këshilltar në Ministrinë e Financave për hartimin e këtyre udhëzimeve administrative, Flutura Hoxha – MAPL, Shemsedin Thaqi – Menaxher i Zyrës së Tatimit në Pronë, Komuna Prishtinë, Bashkim Shaqiri – Agjencioni Kadastral i Kosovës.

Gjatë takimit u diskutua për dy dokumente:

Udhëzimi Administrativ për Funkcionimin dhe Organizimin e Zyrave të Tatimit në Pronë

Sugjerimet nga përfaqësues të shoqërisë civile, përkrahur nga CiviKos

- Në kapitullin II Neni 3 të shtohet pika 4: Zyrtarët duhet të jenë me përgatitje shkollore pvrkatëse për pozitën, përgatitje adekuate shkollore dhe jo kandidat me shkollë të mesme.
- Në kapitullin III Neni 12 pika 1.2 të qartësohet nxitja e respektimit vullnetarë, (të sqarohet se kush duhet nxitur: qytetarët, palët tjera të interesit etj, si dhe kush janë këto palë që duhen nxitur)
- Neni 14 të riformulohet: Zyrtarët e zyrave të tatimit në pronë punojnë në përputhje me dispozitat e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- Në kapitullin IV Neni 16 të hiqen fjalët e tepërta dhe të shkruhet: Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet udhëzimi administrativ Nr. 10/2011.

Gjate diskutimeve në grupin punues përfaqësues të shoqërisë civile ndër të tjera kan kontribuar edhe në dokumentin tjetër draft UA për metodologjinë e vlerësimit në Nenin 2 pika 1.12 u sugjerua që:

- Termi apartament të zëvendësohet me banesë për arsye se tek kosovarët është kjo terminologji që përdoret dhe kuptohet më mirë si e tillë.
- Pika 1.50 ndërtesë apartamentesh të zëvendësohet me ndërtesë banesor.
- Tek pika 1.52 mosha efektive e pronës të zëvendësohet me termin vjetërsia e pronës pasi që fjala moshë më shumë përdoret për njerëzit e jo për objektet.

Debati u zhvillua rreth asaj se mos vallë po tentohet që përmes këtij drafti të merret autonomia e komunave, pasi që në njëfarë forme po centralizohet vetë puna rreth tatimit në pronë, pasi që komunat po e humbin fuqinë në këtë fushë në raport me nivelin qendror.

Disa nga të pranishmit nuk u pajtuan me këtë konstatim duke theksuar se komunat kanë kapacitete të kufizuara në këtë drejtim dhe se përkrahja nga niveli qendror është e mirëseardhur marrë parasysh se komunat kanë mungesë të kapaciteteve humane dhe financiare për t'u angazhuar në terren.

Takimi i tretë - rreth Udhëzimit Administrativ për Procedurat Ankimore, për Funksionimin e Zyrave Për Tatimin në Pronë, si dhe ai Për Metodologjinë e Vlerësimit

14 gusht 2018, Prishtinë, Ministria e financave

Takimi fillimisht u hap nga kryesuesi i këtij takimi nga zt. Shkëlzen Morina – Drejtor i departamen-

tit për tatimin në pronë. Zt. Motina fillimisht i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe njehrit falënderoj edhe kontributin e dhënë nga shoqëria civile pasi që e potencoi se komentet janë dërguar përmes formës elektronike. Ai gjithashtu potencoi edhe njehërë rëndësinë që këto dokumente të mund të rishikohen dhe të jepen komentet e nevojshme sidomos në Draft Udhëzimin Administrativ për metodologjinë e vlerësimit. Në Draft Udhëzimin Adiminstrativ për Metodologjinë e Vlerësimit parashihet që të njëjtën ditë ose më së largu gjatë javës të dërgohet në dëgjim paraprak e të cilit do t'i nevojiten pesëmbëdhjetë (15) ditë për shqyrtim (sipas ekspertit ligjor nëse procedura përshpejtohet ndoshta edhe dhjetë (10) ditë do të jenë të mjaftueshme) në mënyrë që më pastaj të procedohet tutje në dëgjim publik e i cili po ashtu merr pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Derisa përfaqësuesi i Komunës së Gjakovës sugjeroj që siç është dhënë tek pika 1.33. Parcelë për impiant elektrik të aprovohet edhe sugjerimi i tij që të përfshihet edhe një pikë tjetër që specifikon Parcelë për Teknologji Informative apo pajisje (pasi që i njëjti e ceku një rast ku Komuna e Gjakovës sipas të gjitha gjasave është duke e humbur një kontekst gjyqësor me IPKO-n vetë e vetë se disa gjëra nuk janë specifikuar si duhet në udhëzimin e mëhershëm por në disa raste edhe ligjet në fuqi dalin me mangësi).

Takimi i Grupit Punues nga Shoqëria Civile

Menjëherë pas takimit të parë të grupit punues ndërministrorë është organizuar takimi me OJQ-të të cilat kanë shprehë interesimin të jenë në grupin punues për kontribut në Udhëzimet administrative nga Ministria e Financave të përkrahura nga Civikos

Katër Organizata ishin prezente, CBM, Shoqata e Bleshkatarëve, Bridge Film Fest, si dhe Gorani Association.

Tre Udhëzime Administrative janë dërguar tek grupi përmes postës elektronike një javë para takimit të cilat janë shikuar nga grupi dhe në takim këto janë diskutuar dhe janë dhënë rekomandime për ndryshime dhe plotësime. OJQ Konsumatori në pamundësi të jenë prezent rekomandimet e tyre i kanë dërguar përmes emailit.

Rekomandimet nga shoqëria civile janë vendosur në mënyrë të drejtpërdrejt në Draft Udhëzimet Administrative.

VLERËSIME

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave vlerësuan shumë pozitivisht kontributet që kanë ardhur nga shoqëria civile, duke vlerësuar profesionalizmin dhe përpjekjet për dokumente më të implementueshme.

Duhet përmendur se përfaqësuesi i shoqërisë civile ka qenë prezent në të gjitha takimet këto tre (3)

të organizuara të grupit punues ndërministrorë. Takimi i dytë ishte më përmbajtjesorë ku u diskutuan ndryshimet plotësimet dhe rekomandimet për përmirësimin e tre (3) Udhëzimeve Administrative të lartshënuara.

Pas përfundimit të takimeve përfaqëusesit e shoqërisë civile që ishin pjesë e grupeve punuese përmes koordinatorit të grupit i kanë dërguar komentet edhe në formë elektronike.

Disa nga problemet/sfidat e identifikuar gjatë procesit të konsultimit publik

Procesi është vlerësuar si i ngadalshëm ku dhe ka pasur kritika që takimet nuk kanë qenë të organizuara mirë, në mënyrë që të jenë më produktive. Është rekomanduar që në takime të shkohet me radhë nëpër nene dhe nëse ka rekomandime të jepen ato aty për aty por kjo jo gjithmonë është marrë parasysh. Gjithashtu është sygjëruar nga pjesëmarrësit në grupin punues që të paraqiten dokumentet përmes projektorit në mënyrë që sugjerimet për ndryshime të shihen nga të gjithë pjesëmarrësit, gjë që në disa raste nuk ka qenë e mundur.

Në takimet e grupit punues jo gjithmonë kanë marr pjesë personat e njëjtë, gjë që e ka penguar procesin ku nuk ka pasur vazhdimësi.

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Në bazë të zhvillimeve të këtij procesi të konsultimit publik, konsideroj se është e rëndësishme që në të ardhmen të adresohen dhe përmirësohen këto çështje:

- Ministritë të bëjnë më shumë përpjekje që të punohet më shumë në përmbajtje dhe të mos organizohen këto takime vetëm sa për të përmbushur planin.
- Procesi të ketë një intenzitet më të lartë, dhe mos të ketë ndërprerje duke u siguruar që personat e njëjtë të marrin pjesë.
- Organizatorët të marrin parasyshë rekomandimet dhe sygjërimet e grupit për një punë më efikase të grupit.
- Të organizohet takimi publik fillestar me palët e intersuara (para hartimit të dokumentit).

CiviKos do të vazhdoj të përcjell procesin e konsultimit publik për këto Udhëzime Administrative, duke u siguruar që kontributi i shoqërisë civile të reflektoj në të gjitha dokumentet .

Mbështetur nga:



Kingdom of the Netherlands

Zbatuar nga:

